

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|----------|
| Gani Dizdari | Kryesues |
| Aleksandër Muskaj | Anëtar |
| Edmond Islamaj | Anëtar |
| Shkëlzen Selimi | Anëtar |
| Artan Zeneli | Anëtar |

në seancën gjyqësore të datës 07.11.2012, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURIT: EDUART XHEZO

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprave penale
“Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” mbetur në tentativë
dhe “armëmbajtje pa leje.

Baza Ligjore: enet 79/dh dhe 278/2 të K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.239, datë 26.06.2009 ka vendosur:
Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduart Xhezo për kryerjen e veprës penale të “ Vrasjes me dashje kundër 2 ose më shumë personave, mbetur në tentativë, dhe në bazë të neneve 79/dh – 22 të K.Penal, dënimin e tij me 13 vjet burgim.
Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduart Xhezo për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe në bazë të nenit 278/2 K.Penal dënimin e tij me 2 vjet burgim.
Në aplikim të nenit 55/1 të K.Penal, dënimin e tij përfundimisht me 14 vjet burgim.
Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, e dënon me 9 vjet e 4 muaj burgim.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.85 datë 07.05.2008, ka vendosur:
Lënien në fuqi të vendimit nr.239, datë 26.06.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.727, datë 18.02.2009, ka vendosur:
Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri Eduart Xhezo, ndaj vendimit nr.85, datë 07.05.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.319, datë 07.12.2010, ka vendosur:
Rrëzimin e kërkesës penale që i përket: kërkues Eduart Xhezo; Objekti: Rivendosje në afat të rekursit kundër vendimit penal nr.85, datë 07.05.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.22, datë 15.03.2011, ka vendosur:
Ndryshimin e vendimit nr.319, datë 07.12.2010 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë:

Pranimin e kërkesës së kërkesit Eduart Xhezo.

Rivendosjen në afat të tij për të ushtruar rekurs kundër vendimit penal nr.85, datë 07.05.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Kundër vendimit nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës të Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs i pandehuri Eduart Xhezo, cili kërkon:

Ndryshimin e vendimit nr.239, datë 26.06.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit nr.85, datë 07.05.2008 të Gjykatës të Apelit Vlorë, duke bërë ndryshimin e kualifikimit ligjor nga vrasje në rrethana të tjera cilësuese në kanosje dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, duke parashtruar këto shkaqe:

- i Gjykatat nuk kanë zbatuar drejt ligjin penal
- i Janë lejuar shkelje të rënda procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.
- i Ngjarja ka ndodhur më datë 09.12.2005 dhe regjistrimi i procedimit penal në prokurori është bërë më datë 15.12.2005, në këto kushte proces-verbali për vlerësimin e sekuestros i firmosur nga prokurori i çështjes me datë 11.12.2005, është absolutisht i pavlefshëm, pasi ai është ngarkuar me hetimin e kësaj çështje 4 ditë pas nënshkrimit të këtij proces-verbali.
- i Procedura e njoftimit të të pandehurit nuk është bërë konform nenit 247 të Kodit të Procedurës Penale.
- i Deklarimi i mos gjetjes së të pandehurit është bërë më datë 15.03.2006 datë e cila ka qenë dita e fundit e mbarimit të afatit tre mujor dhe ka caktuar mbrojtës kryesisht. Një ditë pas mbarimit të afatit hetimor është realizuar njohja e të pandehurit me materialet, është bërë kërkesa për gjykim dhe dërguar çështja në gjykatë, veprime këto të kryera të gjitha jashtë afatit, gjë që çon në pavlefshmëri absolute të veprimeve hetimore.
- i Një pavlefshmëri tjetër është administrimi si provë i dëshmisë së shtetasit Luan Xhezaq, që pas sjell të njëjtën pavlefshmëri, sepse nuk janë zbatuar dispozitat e nenit 158/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- i Fakti që i gjykuari ka kërkuar gjykim të shkurtuar nuk nënkupton pranimin e akteve absolutisht të pavlefshme.
- i Është e vërtetë se është qëlluar nga i pandehuri me automatik, por ai nuk ka patur kursesi për qellim vrasjen e dy personave Kreshnik Ramës e Bledar Mustafai, ai ka qëlluar për ti trembur ata.
- i Fillimisht duhet të diskutohej për tentativë të metë në kryerjen e veprës penale, pasi nuk janë kryer të gjitha veprimet që sipas tij do të sillnin pasojën kriminale.
- i I pandehuri ka hequr dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale, megjithëse personat nuk janë larguar dhe ai ka pasur fishekë mjaftueshëm në armën e tij.
- i Fakti që shkrepja e armës, është bërë në distancë të afërt, siç arsyeton gjykata nuk do të thotë se ai duhet të përgjigjet për vrasje të mbetur në tentativë.
- i Në bazë të provave të grumbulluara në gjykim, rezulton se nuk ndodhemi para veprës penale të vrasjes mbetur në tentativë, por veprën penale të kanosjes serioze për vrasje.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Shkëlzen Selimi; prokurorin Artur Selmani, i cili kërkoji lënien në fuqi të vendimit nr.85, datë 07.05.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë; av. Enkeleida Petanaj, e cila kërkoji ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Vendimi nr.85, datë 07.05.2008 i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimi nr.239, date

26.06.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është pjesërisht i mbështetur në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet të ndryshohet.

i Rrethanat e faktit

Nga shqyrtimi gjyqësor në gjykatën e apelit rezulton të jenë provuar këto rrethana fakti:

- i I gjykuari Eduart Xhezo është banor i qytetit të Vlorës me profesion tregtar zarzavatesh. Së bashku me familjen e tij ai ushtron aktivitet tregtar në shitjen me shumicë të fruta perimeve në tregun e shumicës të qytetit.
- i Në datë 09.12.2005 rreth orës 07.00 të mëngjesit i gjykuari ka qenë duke shitur në dyqanin e tij. Në këtë orë kanë ardhur për t'u furnizuar me artikuj bujqësor shtetasit Skënder Rama dhe Klodjan Rama. Midis të gjykuarit, i cili në këtë kohë po shiste dhe këtyre shtetasve gjatë kohës që po peshohej një sasi patatesh ka filluar një debat në lidhje me çmimin e caktuar nga i gjykuari. Si pasojë e mos rënies dakord blerësit janë tërhequr nga blerja e mallit. Ky fakt ka shërbyer si shkak që midis të gjykuarit dhe shtetasve Skënder Rama dhe Klodjan Rama (babë e bir) të fillojë një debat fillimisht me fjalë dhe më pas ka degjeneruar në goditje reciproke fizike.
- i I gjykuari Eduart Xhezo ka marrë një gurë peshë dhe me të ka goditur në kokë shtetasin Klodjan Rama. Grindja është ndërprerë pasi shtetasit Skënder Rama dhe Klodjan Rama janë larguar ndërkohë që i gjykuari ka vazhduar të shesë.
- i I dëmtuari Kreshnik Rama, i cili është djali i Skënder Ramës dhe vëllai i Klodjan Ramës, po atë ditë rreth orës 09.00 të mëngjesit pa patur dijeni në lidhje me grindjen që familjarët e tij kishin patur me të gjykuarin, rastësisht ka shkuar për t'u furnizuar. Nën shoqërinë e shtetasit Bledar Mustafai i dëmtuari duke drejtuar furgonin e mallrave me targë VL1911 C kanë shkuar tek vendi ku shiste i gjykuari.
- i I gjykuari Eduart Xhezo duke kujtuar se të dëmtuarit kishin ardhur të vazhdonin grindjen e familjarëve të tij me të cilët ai ishte përplasur dy orë më parë, ka marrë një armë automatike të cilën ai e mbante pa leje dhe në momentin që furgoni ka ndaluar është afruar dhe në një distancë rreth 7-8 m ka qëlluar në drejtimin e poshtëm të derës së shoferit afër parafangos së makinës dhe pjesës që mban mallra.
- i Predhat e qitura nga arma kanë goditur kabinën e makinës dhe një prej tyre si pasojë e devijimit të flurudhës mbas goditjes në derën e shoferit ka plagosur në këmbë të dëmtuarin Bledar Mustafai, i cili ndodhej i ulur në krahun e kundërt të goditjes në sediljen e pasagjerit.
- i Në bazë të aktit të ekspertimit mjeko-ligjor nr.495, datë 06.03.2006, dëmtimi i marrë nga ky shtetas ka sjellë paaftësi të përkohshme deri në 9 (nëntë) ditë, duke klasifikuar si plagosje e lehtë.
- i I gjykuari mbas këtij veprimi është larguar nga vendi i ngjarjes duke marrë me vete edhe armën e zjarrit duke iu fshehur fillimisht hetimit dhe gjykimit deri në momentin e kapjes së tij.
- i Mbas njoftimit në lidhje me këtë ngjarje janë kryer veprimet e para hetimore duke u bërë kqyrja e vendit të ngjarjes. Në bazë të këtij akti janë gjetur dhe fiksuar me cilësinë e provës, 2 gëzhoja të qitura nga një armë zjarri si dhe janë fiksuar në furgon dëmtimet e marra nga predhat e qitura. Në bazë të aktit të ekspertimit balistik është provuar se gëzhojat dhe predhat janë qitur nga një armë zjarri automatike e kalibrit 7.62 mm, model 56.
- i Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në përfundim të hetimit ka dërguar çështjen për gjykim duke e akuzuar të gjykuarin Eduart Xhezo për veprën penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese të mbetur në tentativë dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake të parashikuar nga nenet 79/dh e 22 dhe 278/2 të Kodit Penal.
- i I gjykuari Eduart Xhezo e ka pranuar se është ai autor i ngjarjes por nuk është dakort me kualifikimin ligjor përse i përket veprës penale të vrasjes në rrethana cilësuese të

ngelur në tentativë duke pretenduar se qëllimi i tij nuk ka qenë t'i vrasë të dëmtuarit por kanosja serioze për jetën.

i Procedurat gjyqësore

- i Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.239, datë 26.06.2009 ka vendosur:
- i Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduart Xhezo për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me dashje kundër 2 ose më shumë personave, mbetur në tentativë dhe në bazë të neneve 79/dh – 22 të K.Penal, dënimin e tij me 13 vjet burgim.
- i Deklarimin fajtor të të pandehurit Eduart Xhezo për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe në bazë të nenit 278/2 K.Penal dënimin e tij me 2 vjet burgim.
- i Në aplikim të nenit 55/1 të K.Penal, dënimin e tij përfundimisht me 14 vjet burgim.
- i Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, e dënon me 9 vjet e 4 muaj burgim.
- i **Gjykata e Apelit Vlorë**, me vendimin nr.85, datë 07.05.2008, ka vendosur:
- i Lënien në fuqi të vendimit nr.239, datë 26.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- i **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë** me vendimin nr.727 datë 18.02.2009 ka vendosur:
- i Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i pandehuri Eduart Xhezo, ndaj vendimit nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë.
- i **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë** me vendimin nr.319, datë 07.12.2010, ka vendosur:
- i Rrëzimin e kërkesës penale që i përket: kërkues Eduart Xhezo, Objekti: Rivendosje në afat të rekursit kundër vendimit penal nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

16. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.22, datë 15.03.2011, ka vendosur:

- i. Ndryshimin e vendimit nr.319, datë 07.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë:
- ii. Pranimin e kërkesës së kërkuesit Eduart Xhezo.
- iii. Rivendosjen në afat të tij për të ushtruar rekurs kundër vendimit penal nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

17. Kundër vendimit nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës të Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs i gjykuari Eduart Xhezo, i cili kërkon ndryshimin e vendimit nr.239, datë 26.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës të Apelit Vlorë, duke bërë ndryshimin e kualifikimit ligjor nga vrasje në rrethana të tjera cilësuese në kanosje dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, duke parashtuar shkaqet e pasqyruara në pjesën hyrëse të vendimit.

III Arsyetimi ligjor i vendimit të ankimuar.

18. Gjykata e Apelit Vlorë ka arritur në konkluzionin se vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë : “...i pandehuri Eduart Xhezo me dashje direkte për shkak të grindjes së ndodhur në mëngjesin e datës 09.12.2005, në magazinën e tij, pasi i dëmtuari Kreshnik Rama me vëllanë e tij nuk kanë blerë patate me çmimin e diktuar prej tij, ka dashur të hakmerret, me pasojë të rëndë për jetën e tyre, gjë e cila rezulton prej anës objektive të kryerjes së veprës penale, largësia 7-8 metra dhe drejtimi i qitjeve (tek furgoni, nga ana e shoferit), nga ku ka qëlluar i pandehuri, arma e zjarrit “Kallashnikov”, e përdorur dhe e drejtuar në pjesën ballore të mjetit (krahu i shoferit), janë konstatuar gëzhgoja të kalibrit 7.62 mm, me makiroftë 77-64 dhe 31-67..fakti që shtetasi Kreshnik Rama në pozicionin që ishte ka parë qartë të pandehurin me armë zjarri në duar, si dhe deklaratimet e dëshmitarëve Skënder Rama dhe Bledar Mustafai, etj përcaktojnë drejtimin e goditjeve, duke pasur për qëllim ardhjen e pasojës, eliminimin fizik të personave që ishin në makinë. Fakti që vepra penale mbeti në tentativë, pra

pasoja nuk ka ardhur për shkaqet e pavarura prej tij, pasi të dëmtuarit Kreshnik Rama e Bledar Mustafai, nuk tentuan të zbrisnin dhe kanë ndenjur në kabinë të furgonit për t'i shpëtuar breshërisë së goditjeve...në rastin konkret veprimi kriminal është realizuar, do ishte vepra e Kanosjes, nëse i pandehuri do të qëllonte në ajër ose objekt, pa ndonjë pasojë...”

i **Në lidhje me rekursin e paraqitur**

19. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se rekursi i të gjykuarit Eduart Xhezo duhet të pranohet dhe vendimi nr.85, datë 07.02.2008, i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.239, datë 26.06.2006, duhet të ndryshohen pjesërisht për zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material në lidhje me kualifikimin e veprës penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese për këtë të gjykuar.

20. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon se kualifikimi nga të dy gjykatat e faktit i veprimeve të të gjykuarit Eduart Xhezo si vrasje me vrasje në rrethana cilësuese e ngelur në tentativë, veprë penale e parashikuar nga neni 79/dh e 22 i Kodit Penal¹ është i gabuar duke arritur në konkluzionin se me veprimet e tij ka kryer veprën penale të kanosjes në dëm të shtetasit Kreshnik Rama të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal² dhe plagosjes së lehtë nga pakujdesia në dëm të shtetasit Bledar Mustafai të parashikuar nga neni 92 i Kodit Penal.³

21. Në bazë të provave të shqyrtuara në të dy shkallët e gjykimit ka rezultuar e provuar se qëllimi kriminal i të gjykuarit Eduart Xhezo nuk ka qenë vrasja e të dëmtuarve Kreshnik Rama dhe Bledar Mustafai, por kërcënimi serioz i jetës. Në bazë të provave të siguruara rezulton se fillimisht i gjykuari ka patur një grindje rastësore me familjarët e të dëmtuarit Kreshnik Rama përkatësisht babai dhe vëllai i të dëmtuarit. Mbas një harku kohor të shkurtër pas rreth dy orësh i dëmtuari pa patur dijeni në lidhje me ngjarjen, i shoqëruar nga i dëmtuari tjetër Bledar Mustafai ka shkuar në vendin ku shiste i gjykuari për të kryer furnizim.

22. I gjykuari duke kujtuar se veprimet e të dëmtuarit ishin në vazhdim të një konfrontimi fizik të familjarëve të tij, duke e ndjerë veten i kërcënuar, është përpjekur të dekurajojë sulmin e mëtejshëm të të dëmtuarit. Në realizim të idesë së tij atij i ka lindur ideja e kanosjes me një armë zjarri, të cilën e mbante pa leje në vendin e punës. Në momentin që ka parë që furgoni ka ndaluar dhe i dëmtuari do të drejtohej në vendin ku ai shiste, i gjykuari ka qëlluar në një distancë rreth 7-8 metra nga automjeti. Pavarësisht se i gjykuari i ka patur të gjitha mundësitë të qëllonte në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj të dëmtuarve, të cilët ndodheshin përkatësisht në vendin e shoferit dhe të pasagjerit, që janë pjesën e ekspozuar të kabinës së furgonit, ai i ka drejtuar plumbat në pjesën anësore metalike ndërmjet derës së shoferit dhe kabinës së mallrave larg të dëmtuarve dhe në drejtim të prirët me ta.

23. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se nga ana e gjykatës së apelit dhe e shkallës së parë nuk është arritur në një konkluzion të drejtë në bazë të të gjitha provave të shqyrtuara dhe të fakteve të provuara, ç'ka ka çuar në një konkluzion të gabuar për sa

¹ Neni 79 “**Vrasje në rrethana të tjera cilësuese**”.

Vrasja me dashje e kryer: dh) dh) kundër dy ose më shumë personave;

N.22 i K.Penal “**Kuptimi i tentativës**”

Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

² Neni 84 i K.Penal “**Kanosja**”

Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

³ Neni 92 i K.Penal “**Plagosja e lehtë nga pakujdesia**”

Plagosja e lehtë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

i përket kualifikimit ligjor të faktit penal të ndodhur në lidhje me veprën penale të vrasjes në rrethana cilësuese të ngelur në tentativë. Ky veprim bie ndesh me nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se: “1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi...”.

24. Gjykatat e faktit nuk kanë arritur në një konkluzion logjik në lidhje me kualifikimin ligjor që duhet ti bëhet faktit penal, përse i përket kualifikimit ligjor që duhet t'i bëhet marrëdhënies juridike që është cenuar nga veprimet e kundra ligjshme të të gjykuarit.

25. Kolegji Penal vlerëson se, veprimeve të kryera nga i gjykuari Eduart Xhezo duhet t'i jepet kualifikim tjetër ligjor dhe se ai duhet të deklarohet fajtor për veprën penale të kanosjes në dëm të të dëmtuarit Kreshnik Rama, ndërsa për plagosjen e lehtë nga pakujdesia në dëm të të dëmtuarit Bledar Mustafai, duke qenë se ndiqet në bazë të ankimit të të dëmtuarit, mungon ankimi dhe nuk mund të procedohet.

26. Nga analiza e provave të marra dhe të shqyrtuara nga gjykatat e faktit arrihet në konkluzionin logjik se qëllimi kriminal i të gjykuarit Eduart Xhezo nuk ka qenë vrasja e të dëmtuarve, por kanosja serioze për jetën. Të dyja gjykatat kanë bërë një interpretim të gabuar të objektit juridik të cenuar nga i gjykuari.

27. Kodi Penal ka përmbledhur në Kreun II të tij Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës të cilat kanë për objekt marrëdhënien juridike posaçërisht të mbrojtur nga ligji penal që ka të bëjë me jetën si një e drejtë natyrore dhe fundamentale nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e individit. Në seksionin e I-rë janë përfshirë krimet kundër jetës të kryera me dashje ku përcaktimi grupor i figurave të ndryshme të veprave penale përcaktohet në bazë të elementit të anës subjektive dhe konkretisht dashjes. Përkufizimi i dashjes si element i domosdoshëm i veprës penale është parashikuar në pjesën e përgjithshme dhe konkretisht në nenin 15 të Kodit Penal⁴.

28. Kualifikimi ligjor i drejtë i veprës penale ka të bëjë para së gjithash me aplikimin e ligjit penal nga gjykata për dhënien e një vendimi të drejtë e të bazuar në ligj. Në këtë kuptim interpretimi i një elementi të ndërgjegjes së individit që kryen në një veprë penale është sa e vështirë ashtu edhe e rëndësishme për përcaktimin e fajësisë nëpërmjet kualifikimit ligjor. Natyrisht ky perceptim për gjykatën nuk duhet bërë mbi baza subjektive por në bazë të “leximit” të veprimeve konkrete dhe të vlerësimit në harmoni të të gjitha provave dhe të konkluzionit që del prej tyre.

29. Kolegji Penal vlerëson se, dy gjykatat kanë gabuar kur kanë arritur në konkluzionin se qëllimi kriminal i të gjykuarit ka qenë marrja e jetës të të dy të dëmtuarve e ngelur në tentativë, ç'ka i ka çuar në kualifikimin e gabuar ligjor sipas nenit 79/dh e 22 të Kodit Penal. Ky konkluzion i gabuar ka ardhur si rezultat i aplikimit mekanik të ligjit duke u nisur nga cenimi i jetës se më shumë se një njeriu si rrethanë cilësuese, pa iu referuar faktit nëse i gjykuari ka patur si qëllim marrjen e jetës së të dëmtuarve apo vetëm kanosjen.

30. Të dy gjykatat kanë arritur në konkluzionin e gabuar se vepra penale e vrasjes ka ngelur në tentativë në kundërshtim me nenin 22 Kodit Penal duke mos përcaktuar se cila ka qenë pengesa për të gjykuarin Eduart Xhezo në ardhjen e pasojës së vdekjes së të dëmtuarve. Nga të gjitha provat provohet se qëllimi kriminal i të gjykuarit nuk ka qenë marrja e jetës, por kërcënim i jetës së të dëmtuarve. I gjykuari ka patur mundësi me armën automatike që dispononte, që në rast se dëshironte ti vriste dhe ta realizonte qëllimin kriminal.

31. I gjykuari siç del nga deklarimet e të dëmtuarve ka qenë në një distancë prej 7-8

⁴ Neni 15 K.Penal “Dashja”

Vepra penale kryhet me dashje, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre ose, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre.

metra nga furgoni ku ata ndodheshin. Gjithashtu nga proces-verbali i kqyrjes së vendit të ngjarjes furgonit me targë VL1911 C rezulton se dëmtimet e shkaktuara nga predhat e qitura nga arma e të gjykuarit janë të lokalizuara në pjesën anësore ndarëse midis zonës ku rri shoferi dhe asaj të mallrave ndërkohë që pjesa tjetër e tejdukshme e kabinës është e pacenuar. Kjo do të thotë që megjithëse i gjykuari i kishte të gjitha mundësitë jo vetëm nga distanca e afërt, por edhe pamja krejtësisht e lirë për të shënjestruar të dëmtuarit nuk ka qëlluar në drejtim të tyre por të furgonit ku ata ndodheshin në pjesë metalike të furgonit. Ky fakt provon se i gjykuari nuk ka patur qëllim vrasjen e të dëmtuarve apo dëmtimin e shëndetit të tyre por vetëm kërcënimin e jetës.

32. Gjykatat kanë gabuar kur kanë interpretuar si qëllim kriminal për t'i shkaktuar vdekje faktin e plagosjes së lehtë të të dëmtuarit Bledar Mustafai pa analizuar rrethanat se si ka ndodhur ajo. Në bazë të deklarimeve të këtij të dëmtuari e përputhur ajo dhe me dëmtimet e automjetit nga predhat rezulton se i dëmtuari ka qenë i ulur në vendin e pasagjerit pra në kahun e kundërt të qitjes me armë nga i gjykuari. Në bazë të mekanizmit të zhvillimit të ngjarjes rezulton e provuar se plagosja e lehtë e të dëmtuarit Bledar Mustafai në këmbë ka ardhur jo si pasojë e qitjes së drejtpërdrejtë nga i gjykuari por si rezultat i ndryshimit të flurudhës së plumbit pas goditjes në metalin e kabinës së furgonit. Ky fakt i provuar shkencërisht hedh poshtë argumentin e gjykatës se qëllimi kriminal i të gjykuarit ka qenë vrasja e tyre.

33. Në rastin e të dëmtuarit Bledar Mustafai kemi të bëjmë me një plagosje të lehtë nga pakujdesia në formën e neglizhencës pasi i gjykuari nuk parashikoi mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme nga veprimet e tij, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte.

34. Kolegji Penal vlerëson se del e provuar se qëllimi i të gjykuarit nuk ka qenë vrasja, por kanosja e të dëmtuarve në jetën e tyre. Nga aktet e fashikullit të gjykimit provohet se përdorimi i armës nga i gjykuari ka qenë në funksion të mendimit të tij kriminal për t'i dekurajuar të dëmtuarit në aksionin e tyre si pjesë e mendimit të gabuar që kishte krijuar si pasojë e zënkës që ai kishte patur disa orë përpara ngjarjes me familjarët e të dëmtuarit Kreshnik Rama. Drejtimi i qitjes ka qenë jashtë kontureve fizike të të dëmtuarve dhe për më tepër në një zonë të furgonit që nuk kishte asnjë pjesë të trupit me funksione vitale për të vënë në rrezik jetën e tyre.

35. Objekti i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet shoqërore të mbrojtura posaçërisht nga ligji, që garantojnë jetën dhe shëndetin e personit, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme.

36. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji duhet që: nga ana objektive të plotësojnë disa kushte: a) të jenë serioze, d.m.th nga forma dhe përmbajtja të mos lenë asnjë dyshim tek i dëmtuari se, vepra për të cilën po kanoset do të realizohet patjetër. Vlerësimi nëse kanosja është serioze bëhet rast pas rasti, duke marrë parasysh rrethanat konkrete në të cilat zhvillohet ngjarja, karakterin dhe intensitetin e veprimeve kanosëse, mjetin dhe mënyrën me të cilën realizohet ajo, etj... b) kanosja duhet të bëhet për vrasje dhe për plagosje të rëndë dhe jo për ndonjë vepër tjetër penale. Në rastin në shqyrtim, kanosja ka qenë serioze pasi mjeti i përdorur është arma e zjarrit e për më tepër përdorimi i saj në funksion të këtij qëllim ka krijuar plotësisht bindjen tek të dëmtuarit se jeta e tyre është në rrezik.

37. I gjykuari Eduart Xhezo është subjekt madhor dhe i përgjegjshëm para ligjit e vërtetuar kjo në bazë të akteve të gjendjes civile si dhe të shëndetit mendor që ai gëzon.

38. Veprën penale të kanosjes ka kryer me dashje direkte i shtyrë nga motive të dobëta.

39. Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit Kolegji Penal mban parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe të autorit si dhe rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Në kuptim të nenit 48, gërma “e” të Kodit

Penal si rrethanë lehtësuese mban parasysh normalizimin e marrëdhënieve me të dëmtuarit ç'ka provohet nga deklaratat noteriale të lëshuara prej tyre të administruara në fashikullin e gjykimit.

40. Përsa i përket veprës së plagosjes së lehtë të shtetasit Bledar Mustafai në kushtet që u provua se ajo ka ardhur nga pakujdesia kualifikohet në bazë të nenit 92 të Kodit Penal dhe për shkak të rrezikshmërisë së paket shoqërore si vepër është parashikuar ndjekja e saj me akuzë private në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjykatë me iniciativën e të dëmtuarit akuzues. Sipas nenit 59 të K.Pr.Penale⁵ procedimi i të gjykuarit për këtë kundra vajtje penale mund të bëhet vetëm nga i dëmtuari nëse një gjë të tillë e çmon drejtpërsëdrejti në gjykatë.

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

41. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se duke ndryshuar kualifikimin e veprës penale i gjykuari me veprimet e saj ka konsumuar veprën penale të kanosjes të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal dhe duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit përsa i përket deklarimit fajtor për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441/1, gërma "b" të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

1. Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr.85, datë 07.05.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe të vendimit nr.239, datë 26.06.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë:

Deklarimin fajtor të të gjykuarit Eduart Xhezo për veprën penale të kanosjes të parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal duke e dënuar me 1 (një) vit burgim.

2. Lënie në fuqi të vendimit përsa i përket deklarimit fajtor dhe masës së dënimit për të gjykuarin Eduart Xhezo për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

3. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon të gjykuarin Eduart Xhezo me një dënim të vetëm me 3 (tre) vjet burgim.

4. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale ulet 1/3 e dënimit dhe e dënon përfundimisht të gjykuarin Eduart Xhezo me 2 (dy) vjet burgim.

5. Urdhërohet prokurori pranë Gjykatës së Lartë për ekzekutimin e këtij vendimi.

Tiranë, më 07.11.2012

⁵ Neni 59 K.Pr.Penale "I dëmtuari akuzues"

1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.